



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2022:197807

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05465661

C.nr.1444/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Blerina KURTAJ, dhe me bashkëpunëtoren profesionale Ardiana Nikollbibaj Thaqi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit L.L nga Gjakova, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 403.49 euro, jashtë seance me 18 mars 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit L.L nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – DKA, që paditësit të lartcekur, në emër të shpërblimit jubilar për 23 vite përvojë pune, të ia paguajë shumën prej 344.25 euro me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet nga data 22.09.2022 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 98.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II.REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të shpërblimit jubilar në shumën prej 59.24 euro.

## A r s y e t i m

Paditësi L.L nga Gjakova në këtë gjykatë me datë 22.09.2022, përmes të autorizuarit të tij Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, për kompensimin e shpërblimit jubilar, duke theksuar se paditësi ka qenë i punësuar si mësimdhënës i lëndës së TIK-ut në Institucionin Arsimor SHME “...” në Gjakovë, me përvojë pune 23 vjeçare tek e paditura. Përkundër detyrimeve që e paditura ka konform nenit 35 par.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e njëjta nuk e ka përmbushur obligimin e saj për kompensimin e paditësit në vlerën e 75% të pagës bazë si shpërblim jubilar për përvojën e punës 37 vjeçare. Ndërsa më parashtresën e datës 20.02.2024 i autorizuari i paditësit e ka precizuar padinw ashtu qw, ka kërkuar kompensimin e paditësit në vlerën e 75% të pagës bazë si shpërblim jubilar për përvojën e punës 23 vjeçare që në emër të shpërblimit jubilar, e paditura të ia paguajë paditësit shumën prej 403.49 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – DKA, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 22.03.2023, nder të tjera ka parashtruar se e kundërshtojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se kontrata kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse konsideron se është kundërshtim me ligjin e punës, ngase me nenin 90 pika 5 thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në këtë rast e paditura Komuna e Gjakovës si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje por është Ministria në njëjërën anë dhe SBASHKU në anën tjetër e me të cilën Kontratë nuk përfshihet Komuna e Gjakovës –DKA si subjekt juridik dhe punëdhënës i paditësit ngase secila organizatë buxhetore e ka buxhetin e vet dhe e planifikon për vitet në vijim e në ç rast e paditura nuk ka qenë nënshkruese e kësaj kontrate e as nuk ka planifikuar buxhet për lëndët e kësaj natyre. E paditura nder të tjera është thirrur edhe në institutin e parashkrimit të kërkesës e që e drejta e paditësit për të kërkuar kompensimin e shpërblimit jubilar është parashkuar,

ashtu që ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shpërblim jubilar, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadisë rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.”* Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shpërblim jubilar, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësit dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditësin.

Gjykata, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, e lidhur me 35 paragrafi 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 18.04.2017, si dhe të datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit”* [8.2] *“për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75 % të një page bazë”* Andaj gjykata erdhi në përfundim se paditësit i takon shuma si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që nga lista e pagave e datës 01.11.2021 e deri me 30.11.2021 vërtetohet se i njëjti ka mbi 20 vite provoj punë, dhe për shpërblim jubilar i takon 75% të një pagë bazë e cila pagë është në shumën prej 459.00 euro. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën e gjykuar si në dispozitivit I të këtij aktgjykimi.

Në neni 329 par. 1 të LPK-së parashihet që: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve (listës së pagave), gjykata iu fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e saj.

Në anën tjetër, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesërisht kërkesën e paditësit Lulzim Lila në shumën prej 59.24 euro, duke ja njohur vetëm përqindjen në paga mujore bazë, bazuar në listën e pagave e cila gjendet në shkresat e lëndës.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata pas ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritore të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “*Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.*

Gjykata vlerëson së paga mujore neto e paraqitur në listën e pagave, nuk mund të jenë objekt përfitimi nga paditësi, pasi që legjislacioni aktual i punës ka bërë dallimin e pagës bazë me shtesat tjera. Me nenin 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, është paraparë se “*Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës*”. Pra përcaktimi ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë dhe shtesa nga paga. Në anën tjetër, me nenin 35 paragrafi 8 pika 8.2 e Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, parashihet se i punësuari ka të drejtën e realizimit të një 75% të një page bazë, e që nuk i përfshinë shtesat tjera nga paga.

Në nenin 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit parashihet se “*Punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit* “. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar, i njëjti është legjitimuar që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësi ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, parashihet se “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të

gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shumën e gjykuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së, llogaritja e kamatës është bërë nga data e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, është marrë sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditësit iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 98.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësorë në vlerë prej 20.00 euro, (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shumën prej 78.00 euro (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1444/22, me 18 mars 2024

G J Y Q T A R J A,

Blerina KURTAJ

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.